

**VENDIM**  
**Nr. 213, datë 16.3.2016**

**PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM FAMILJARËVE NË NGARKIM TË TË  
NDJERIT LIRAK BEJKO**

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie, përjashtimisht nga kriteret e vendimit nr. 429, datë 12.2.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të një pensioni të posaçëm familjar për personat në ngarkim të të ndjerit Lirak Bejko.

2. Pensioni i posaçëm familjar ose shtesa e pensionit familjar të jetë deri në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Përfitues të pensionit ose shtesës së pensionit janë personat e përcaktuar sipas kushteve që parashikon neni 40, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shuma, kur kërkohet nga familjarët, jepet e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.

3. Efekti financiar për vitin 2016, prej 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, dhe për vitet në vazhdim të përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore.

4. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë e botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.4.2016.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**